



Datë: 17.03.2025

Numër protokoll: 1752/2025

A.nr.32/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji** për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari--anëtarë, me Sabile Avdyli-në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.32/2025 të datës 08.01.2025 të parashtruar nga grup ankuesish në përbërje prej 125 (njëqind e njëzetë e pesë) zyrtarë të punësuar në Komunën e Kaçanikut, ankesë e cila në Këshill është e regjistruar në emër të ankuesit F.R. U.M, ndërsa me autorizim i përfaqëson Avokat Esat Syla, nga Komuna e Skenderajt, kundër organit të punësimit/Komuna e Kaçanikut, në çështjen juridike “*Kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 17.03.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet** ankesa me numër A.nr.32/2025, e datës 08.01.2025 e ankuesve; R.S. B.C. F. Ç, A.SH,V.D, F.G, B.D, F.E, H.ZH, SH.S, S.S, H.SH, V.K, I.K, A.T, B.B, M. K, E.B, S.K, A.F, A.R, H.K, J.D, K.Ç, D.E, E.F, Xh.G, J.T, F.D, V.E,R.B, F.B, Ç.L, E. T, A.A, G.G, O.I,N.L, E.K, E. B-G, S.D, H.D, B.S, G. K-S, V.D, R.M, M.D, B.D, M.A, A.ZH, L.M, M.F,U. Ç, F.R, K.L, R.SH, XH.D, A.V,F,N, M.M, B.M, V.M, M.SH, K.K, I.K, SH.K, A.K, Ç.T, M.L, Z.K, SH.C, M.M, H.G, F.V, A.K, F.L, E.P, A.L, I.L, E.M, I.M, K.L, XH.L, F.I, H.M, A.D, A.K, M.B, A.Ç, M.S-V dhe F.G, kështu që **detyrohet** Kryetari i Komunës së Kaçanikut, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimit, dhe të ndërmarr veprimet që të shqyrtoj kërkesën e datës 16.10.2024 të ankuesve.

**II.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **shpallet jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.32/2025, të datës 08.01.2025, të parashtruar nga ankuesit U.M, F.K, A.G, SH.K,V.B, B.M-N, H.R, V.E, B.T, Z.G,A.D, B.RR, G.L, R.ZH,I.B.M.R,

A.TH,B.D, A.B, N.K, Y.SH, A.B, I.L, V.M, N.D, A.K, Xh.A, A.P, SH.L, Z.H, A.T, F.M, B.SH dhe L.G.

**III.** Lënda e ankuesve sipas pikën II të dispozitivit të këtij vendimi i delegohet për shqyrtim Komisionit për Ankesa në Komunën e Kaçanikut.

**IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra si në pikën I të dispozitivit.

### **A r s y e t i m**

Ankuesit si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij vendimi, përmes përfaqësuesit të tyre Avokat Esat Syla, përmes pozitës më datë 01.01.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 08.01.2025 dhe është regjistruar me numër A.nr.32/2025 dhe numër protokollit 55/2025, kundër Komunës së Kaçanikut, me të cilën kërkojnë shtesën në pagë prej 0.5% nga data 06.02.2023 e tutje, shtesat SHCK në pagë 31.20 euro në muaj për secilin nëpunës nga data 06.02.2023 e tutje ashtu siç kanë realizuar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, dhe shujtat nga 4 euro për secilën ditë të pranisë në punës nga vitit 2021 e deri në tani duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë me Nr. 08/48 të datës 09.09.2015.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datës 27.01.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Shtimes, ndërsa kjo e fundit më datë 19.02.2025 ka dërguar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

***Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova:*** Ankesën me numër protokollit 56/2025 të datës 08.01.2025, e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vërtetim mbi pranimin e dërgesës i datës 11.11.2024; Mendimin Juridik të datës 09.10.2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr. 08/48 të datës 09.09.2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Zarfën e datës 01.01.2025; Autorizimet për përfaqësim; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 23.01.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 19.02.2025; Akt Emërimi i datës 10.06.2024 për A.Ç.; Akt Emërimi i datës 22.11.2012 për B.D; Akt Emërimi i datës 23.07.2024 për B.C.V; Akt Emërimi i datës 17.12.2012 për F.R; Akt Emërimi i datës 10.05.2024 për F.I; Akt Emërimi i datës 10.06.2024 për A.K; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për A.K; Akt Emërimi i datës 10.06.2024 për A.D; Akt Emërimi i datës 17.05.2024 për A.A.B; Akt Emërimi i datës 16.05.2024 për A.F; Akt emërimi Emërimi ii datës 15.05.2024 për A.K; Akt Emërimi i datës 31.05.2024 për A.T; Akt

Emërimi i datës 16.05.2024 për A.V; Akt Emërimi i datës 31.05.2024 A.R; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për B.S; Akt Emërimi i datës 15.05.2024 për B.K; Akt Emërimi i datës 15.05.2024 për B.B; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për B.D; Akt Emërimi i datës 17.05.2024 për Ç.L; Akt Emërimi i kt 31.01.2025 për E.P.G; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për E.G; Akt Emërimi i datës 17.05.2024 për E.T; Akt Emërimi i datës 15.05.2024 për E.B; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për E.K; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për F.G; Akt Emërimi i datës 16.05.2024 për F.G; Akt Emërimi i datës 28.06.2024 për F.Q; Akt Emërimi i datës 04.07.2024 për F.V; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për F.D; kt Emërimi i datës 14.05.2024 për F.N; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për F.E; Akt Emërimi ii datës 15.05.2024kt emërimi i datës 10.06.2024 për H.M; Akt Emërimi i datës 15.05.2024 për H.D; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për H.G; Akt Emërimi i datës 16.05.2024 për I.K; Akt Emërimi i datës 27.06.2024 për I.M; Akt Emërimi i datës 21.06.2024 për I.K; Akt Emërimi i datës 17.05.2024 për J.T; Akt Emërimii i datës 15.05.2024 për K.Ç.G; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për K.K; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për K.L; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për M.M; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për M.K; Akt Emërimi i datës 15.05.2024 për M.Sh; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për M.D; Akt Emërimi i datës 15.05.2024 për M.F; Akt Emërimi i datës 27.06.2024 për M.A; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për M.B; Akt Emërimi i datës 31.01.2025 për M.L; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për O.I; Akt Emërimi i datës 16.05.2024 për R.V; Akt Emërimi i datës 17.05.2024 për R.Sh; Akt Emërimi i datës 15.05.2024 për R.M; Akt Emërimi ii datës 17.05.2024 për R.B; Akt Emërimi i datës 15.05.2024 për S.K; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për Sh.K; Akt Emërimi i datës 15.05.2024 për Sh.S;Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për Sh.C; Akt Emërimi i datës 15.05.2024 për 15.05.2024 për S.S; Akt Emërimi i datës 14.05.2024 për U.Ç; Akt Emërimi i datës 15.05.2024 për V.D; Akt Emërimi i datës 16.05.2024 për V.K; Akt Emërimi i datës 31.05.2024 për V.D; Akt Emërimi i datës 15.05.2024 për V.M; Akt Emërimi i datës 15.05.2024 për XH.D; Akt Emërimi i datës 17.05.2024 për Xh.G; Akt Emërimi i datës 31.01.2025 për Z.K; Aëskt Emërimi i datës 31.05.2024 për K.L; Akt Emërimi i datës 05.12.2024 për L.M; Akt Emërimi i datës 10.06.2024 për S.D; Akt Emërimi i datës 10.06.2024 për XH.L; Akt Emërimi i datës 31.12.2012 për H.Sh; Akt Emërimi i datës 31.12.2012 për H.ZH; Akt Emërimi i datës 03.09.2024 për H.K; Akt Emërimi i datës 13.12.2012 për N.L;Akt Emërimi i datës 12.03.2024 për A.SH; **Akt Emërimi i datës 31.07.2013 për A.B; Akt Emërimi i datës 31.07.2013 për A.K; Akt Emërimi i datës 31.07.2013 për A.T; Akt Emërimi i datës 31.07.2013 për A.P; Kontratë Pune për Kohë të Pacaktuar për A.B; Akt Emërimi i datës 31.07.2013 për B.SH; Akt Emërimi ii datës 31.07.2013 për B.D; Akt Emërimi i datës 31.07.2013 për F.M; Akt Emërimi i datës 31.07.2013 për I.L; Akt Emërimi i datës 31.07.2013 për L.G ; Akt Emërimi i datës 31.07.2013 për N.K; Kontratë Pune për Kohë të pacaktuar edatës 01.05.2018 për N.D; Akt Emërimi i datës 31.07.2013 për Sh.L; Akt Emërimi i datës 31.07.2013 për V.M; Akt Emërimi i datës 31.07.2013 për V.K; Akt Emërimi i datës 31.07.2013 për Xh.A; Akt Emërimi i datës 31.07.2013 për Y.Sh; Akt Emërimi i datës 31.07.2013 për Z.H; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 27.06.2024 për Urim Mazreku; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës04.07.2024 përM.R; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 15.05.2024 për Z.G; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 16.05.2024 për V.B; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 17.05.2024 për V.E; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 16.05.2024 për H.R; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 16.05.2024 për G.L; Kontratë pune për Kohë**

të Pacaktuar e datës 27.06.2024 për F.K; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 27.06.2024 për R.Zh; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 16.05.2024 për B.D; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 16.05.2024 për B.M.N; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 27.06.2024 për A.Zh; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 23.05.2022 për B.T; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 03.10.2022 për M.M; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 08.07.2024 për A.Th; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 04.07.2024 për A.D; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 30.10.2025 për B.Rr; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 09.07.2024 për R.S.K; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 12.09.2024 për I.B; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 04.07.2024 për M.R; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 15.05.2024 për Z.G; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 16.05.2024 për V.B; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 17.05.2024 për V.E; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 12.09.2024 për I.B; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 23.05.2022 për B.T; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 27.06.2024 për A.Zh; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 27.06.2024 për A.G ; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 08.07.2024 për A.Th ; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 04.07 për A.D; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 16.05.2024 për H.R. ; Kontratë pune për Kohë të Pacaktuar e datës 03.10.2022 për M.M

**Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se rastin e ankuesve si në pikën I të dispozitivit, lënda kthehet në detyrim për vendosje, sepse:**

Nga shqyrtimi i provave të administruara rrjedhë së ankuesit si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimit, posedojnë Akte të Emërimit dhe rrjedhimisht të gjithë kanë statusin e nëpunësit të shërbimit civil, dhe janë të punësuar në kuadër të Komunës së Kaçanikut.

Ankuesit përmes Avokat Esat Sylja, fillimisht më datë 14.10.2024, kanë parashtruar kërkesë tek Zyra për Burime Njerëzore e Komunës së Kaçanikut me të cilën kanë kërkuar Shujtat për ditët e pranisë në punë për secilin zyrtar të kësaj komunës, duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës si fakt notor; Shtesat në pagë për secilin nëpunës të kësaj komunës prej 0.5% për vitet e përvojës në punë nga nxjerrje e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KO70/23 i datës 23.01.2024; Shtesat SHCK në pagë prej 31.20 euro për muaj për secilin nëpunës, ashtu siç i kanë realizuar para hyrjes në fuqi të Ligjit të Pagave Nr. 08/L-196 i datës 05.01.2023,

Ankuesit ndaj heshtjes administrative të organit të punësimit, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të aprovoj ankesën e tyre dhe të obligoj Komunën e Kaçanikut që të njohë këto të drejta gjegjësisht kompensimin e shtesës në pagë prej 0.5% nga data 06.02.2023 e tutje, shtesës SHCK në pagë 31.20 euro në muaj për secilin nëpunës nga data 06.02.2023 e tutje ashtu siç kanë realizuar para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për

Pagat në Sektorin Publikë, dhe shujtat nga 4 euro për secilën ditë të pranisë në punës nga vitit 2021 e deri në tani duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë me Nr. 08/48 të datës 09.09.2015.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (*tutje referuar: LPPA*), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative*, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj*, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes*, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me Kërkesën e datës 14.10.2024 të parashtruar nga ankuesit, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të shqyrtoj kërkesën e ankuesve të datës 14.10.2024 dhe të nxjerrë akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, heshtja dhe mos përgjigja e organit të administratës në raport me kërkesën e ankuesve të datës 14.10.2024, cenojnë të drejtat e ankuesit në kuptimin e të drejtave procedurale dhe për rrjedhojë edhe vendosjen në mënyrë meritore, ngase, ashtu sikurse është thënë në arsyetim të këtij vendimi, në kërkesën e parashtruar të organi i punësimit, ankuesi pretendon realizimin e një drejtë ligjore.

Kështu që thënë si më sipër e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar ankesën e ankuesit vetëm në kuptim të shkeljeve procedurale, duke detyruar Kryetarin e Komunës së Shtimes, që të shqyrtoj kërkesën e ankuesve të datës 14.10.2024, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe të nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e shqyrtuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit si në pikën II të dispozitivit, **sepse:**

Nga provat e lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi A.B sipas Aktit të Emërimit të datës 31.07.2013 është i punësuar në pozitën Udhëheqës ndrrimi në Departamentin e Zjarrfikëse dhe Shpëtimit, ankuesi A.K sipas Akt Emërimit të datës 31.07.2024 2013 është i punësuar në pozitën Zjarrfikës , ankuesi A.T sipas Akt Emërimit të datës 31.07.2013 është i punësuar në pozitën Zjarrfikës, ankuesi A.P sipas Akt Emërimit të datës 31.07.2013 është i punësuar në pozitën Zjarrfikës, ankuesja A.B sipas Kontratës së punës të datës 16.08.2018 është e punësuar në pozitën zjarrfikës /Vozitës, ankuesi B.Sh sipas Akt Emërimit të datës 31.07.2013 është i punësuar në pozitën zjarrfikës; ankuesi B.D sipas Akt Emërimit të datës 31.07.2013 është i punësuar në pozitën zjarrfikës, ankuesi F.M sipas Akt Emërimit të datës 31.07.2013 është i punësuar në pozitën Zjarrfikës; ankuesi I.L sipas Akt Emërimit të datës 31.07.2013 është i punësuar në pozitën Zjarrfikës, ankuesi L.G sipas Akt Emërimit të datës 31.07.2013 është i punësuar në pozitën Udhëheqës ndrrimi në Departamentin e Zjarrfikëse dhe Shpëtimit, ankuesi N.K sipas Akt Emërimit të datës 31.07.2013 është në pozitën Zyrtar për preventiv dhe hetuesi ndaj zjarrit, ankuesi N.D sipas kontratës së punës të datës 01.05.2018 është në pozitën zjarrfikës, ankuesi Sh.L.sipas Akt Emërimit të datës 31.07.2013 është në pozitën Zjarrfikës, ankuesi V.M sipas Akt Emërimit të datës 31.07.2013 është në pozitën Zjarrfikës, ankuesi V.K. sipas Akt Emërimit të datës 31.07.2013 është i punësuar në pozitën zjarrfikës, ankuesi Xh.A sipas Akt Emërimit të datës 31.07.2013 është në pozitën Udhëheqës Ndrrimi , ankuesi Y.Sh. sipas Akt Emërimit të datës 31.07.2013 është i punësuar në pozitën Komandant i Njësisë Profesionale Zjarrfikëse, ankuesi Z.H sipas Akt Emërimit të datës 31.07.2013 është i punësuar në pozitën Zjarrfikës -voztës, ankuesi B.D sipas Kontratës së punës të datës 16.05.2024 është në pozitën Përgjegjës i Sektorit Teknik, ankuesja B.M sipas kontratës së punës të datës 16.05.2024 është në pozitën pastruese, ankuesi U.M sipas kontratës së punës të datës 27.06.2024 është në pozitën koordinator i Sektorit Teknik, ankuesi M.R sipas kontratës së punës të datës 04.07.2024 është në pozitën punëtor teknik, ankuesja Z.G sipas kontratës së punës të datës 15.05.2024 është në pozitën pastruese, ankuesi V.B sipas kontratës së punës të datës 16.05.2024 është në pozitën mirëmbajtës i objekteve, ankuesja V.E sipas kontratës së punës të datës 17.05.2024 është në pozitën pastruese, ankuesja H.R sipas kontratës së punës të datës 16.05.2024 është në pozitën pastruese, ankuesi G.L sipas kontratës së punës të datës 04.07.2024 është në pozitën punëtor teknik, ankuesi F.K sipas kontratës së punës të datës 27.06.2024 është në pozitën Punëtor teknik, ankuesi R.Zh sipas kontratës së punës të datës 05.11.2012 është në pozitën mirëmbajtës i automjeteve dhe shofer, ankuesi B.D sipas kontratës së punës të datës 16.05.2024 është në pozitën Përgjegjës i sektorit teknik, ankuesja R.S.K sipas kontratës së punës të datës 09.07.2024 është në pozitën bibliotekist, ankuesi I.B.sipas kontratës së punës të datës 12.09.2024 është në pozitën shtëpiak, ankuesi M.R sipas kontratës së punës të datës 04.07.2024 është në pozitën punëtor teknik, ankuesja B.M sipas kontratës së punës të datës 16.05.2024 është në pozitën pastruese, ankuesi B.T sipas kontratës së punës të datës 23.05.2022 është në pozitën vozitës-shofer, ankuesi A.Zh sipas kontratës së punës të datës 27.06.2024 është në pozitën Bibliotekist, ankuesi A.G sipas kontratës së punës të datës 27.06.2024 është në pozitën

Ndihmës punëtor, ankuesi A.Th sipas kontratës së punës të datës 08.07.2024 është në pozitën Mirëmbajtës i objekteve, ankuesi A.D sipas kontratës së punës të datës 04.07.2024 është në pozitën Mirëmbajtës i objekteve, ankuesja M.M sipas kontratës së punës të datës 03.10.2022 është në pozitën Asistente Administrative Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, ankuesi A.D sipas kontratës së punës të datës 04.07.2024 është në pozitën Mirëmbajtës i objekteve, ankuesi A.Zh sipas kontratës së punës të datës 27.06.2024 është në pozitën Bibliotekist dhe ankuesi B.RR sipas kontratës të datës 30.10.2015 është në pozitën zyrtar i nxemjes qendrore.

Kolegji i Këshillit, lidhur me statusin e pozitës së ankuesve të cekur si më lartë, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 5 paragrafi 3 dhe 5 përcakton se: *3. Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës. 5. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike, po ashtu lidhur me nëpunësit e shërbimit publik dhe nëpunësit teknik dhe mbështetës, Kolegji ju referua nenit 77 paragrafi 1 dhe nenit 95 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili parashihet: “nenit 77. 1. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të ligjit, marrëdhënia e punës për nëpunësen/in e shërbimit publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit përkatës të Punës, nenit 95 paragrafi 1 dhe 2, Punëdhënës në marrëdhënien e punës të nëpunëses/it teknik dhe mbështetës është institucioni përkatës, përmes udhëheqëses/it më të lartë administrativ të institucionit. Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të ligjit, marrëdhënia e punës ndërmjet institucionit dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës rregullohet me legjislacionin e punës.*

Andaj Kolegji i Këshillit, referuar dispozitave të cekura ma lartë, konstaton se përveç pozitën, pozitat e lartëcekura që mbajnë ankuesit hyjnë në kuadër të nëpunësit teknik dhe mbështetës, e për rrjedhojë duke marr parasysh që këta ankuesit nuk mbajnë pozitë të nëpunësit të shërbimit civil, atëherë duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që mbi bazë të këtyre pikëpamjeve Kolegji i Këshillit, vendosi që të shpallë veten jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.32/2025 të datës 08.01.2025 të parashtruar nga ankuesit, kështu që lënda e ankuesve për shqyrtim delegohet tek organi kompetentë respektivisht Komisioni i Ankesave i Komunës së Kaçanikut.

***Këshillë juridike:*** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
***Lënda me numër A.nr.32/2025***

**Sabile Avdyli**

---

**Procesmbajtës**

**Eshref Shabani**

---

**Kryetar i Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesve Avokat Esat Sylaj;
- Orgnait të punësimit: Kryetarit të Komunës, Komisionit të Ankesave dhe Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Kaçanikut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.